



Z. Lavdrim Sahitaj – Drejtor i Përgjithshëm

Z. Sahitaj është diplomuar për Ekonomiks në Universitetin Bujqësor të Tiranës në vitin 2003 dhe në vitin 2010 ka përfunduar me sukses Masterin e Shkencave në ‘Administrim Publik’, një program bashkëpunëmi ndërmjet Universitetit të Tiranës dhe Universitetit të Nebraskës, SHBA. Më pas, në vitin 2015, ka mbrojtur disertacionin për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Universitetin European të Tiranës. Ndër specializimet e tij mund të përmendim atë për teknologjinë e informacionit të ndjekur në Bournemouth & Poole College, Bournemouth, Angli.

Ai është pedagog, autor i disa publikimeve dhe artikujve shkencor në fushën e investimeve, mikrofinancës, zhvillimit të qëndrueshëm, strategjive të zhvillimit ekonomik, reformave ekonomike dhe zhvillimit financiar. Këto punime kanë qenë pjesë e konferencave dhe aktiviteteve shkencore ndërkombëtare të mbajtura në vende si Austria, Anglia, Turqia, Mali i Zi dhe Kosova.

Ai ka një përvojë pune afërsisht 15 vjecare në administratën publike dhe akademike. Nga 2004 në 2009, Z.Sahitaj ka qenë pjesë e administratës së qeverisje vendore në Bashkinë e Tiranës duke mbajtur pozicionin e koordinatorit të programit të menaxhimit të informacionit në Drejtorinë e Ujësllësit, mbështetur nga AICS, dhe më pas Koordinator i projektit SWEB. Nga 2014 deri në vitin 2019 ka mbajtur fillimisht detyrën e drejtorit në Degën e Thesarit Tiranë dhe më pas drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit. Gjithashtu, gjatë viteve 2008-2013, ka qenë lektor i lëndëve Menaxhim i Burimeve Njerëzore dhe Menaxhimi i Operacioneve.

Në Shtator 2019, Z.Sahitaj u emërua Kryeinspektor i Inspektoratit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut (ISHMT).

Z. Sahitaj ka njohuri të mira dhe përvojë të suksesshme në menaxhimin e projekteve, ndërveprimin me donatorët dhe aktorët e tjerë institucional të fushës, si dhe aftësi të dalluara në organizimin financiar dhe raportimin, falë përvojës së tij në menaxhim.

Në Maj 2022 mban postin e Drejtorit të Përgjithshëm në Drejtorinë e Përgjithshme të Taksës së Pasurisë në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.